



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 701 Prot.

Durrës, më 14.3.2026

VENDIM

Nr. 40, datë 14.3 2026

PËR

“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 31, DATË 18.11.2024 TË SENATIT AKADEMIK “PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 30, DATË 06.11.2024 PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË NDRYSHIMEVE TË STRUKTURËS SË PËRGJITHSHME DHE ORGANIKËS ANALITIKE TË UNIVERSITETIT ALEKSANDËR MOISIU DURRËS”

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Statutit të UAMD-së, Rregullores së UAMD-së; Vendimit të Senatit akademik nr. 31, datë 18.11.2024; Vendimit të Bordit të Administrimit nr.62, datë 19.11.2026, referuar shkresës së Fakultetit të Edukimit me nr. 504 prot., datë 24.02.2026; shkresës Nr. 504/1 Prot., datë 27.02.2026 të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit, si dhe Vendimit të Senatit Akademik nr. 27, datë 05.03.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin nr. 31, datë 18.11.2024 të Senatit Akademik “Për një ndryshim në Vendimin nr. 30, datë 06.11.2024 për miratimin paraparak të ndryshimeve të strukturës së përgjithshme dhe organikës analitike të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës”.
2. Miratimin paraparak të një ndryshimi në strukturën e Fakultetit të Edukimit, përkatësisht, 1 (një) vend vakant i Departamentit të Psikologjisë i kalon Departamentit të Pedagogjisë:
 - Departamenti i Psikologjisë **ishte** me 12 personel akademik, **bëhet** me 11 personel akademik.
 - Departamenti i Pedagogjisë **ishte** me 13 personel akademik, **bëhet** me 14 personel akademik.
3. Ky vendim i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

